



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 137/26 Dt. 26.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e automjeteve të papërdorura që gjenden në hapësirat komunale. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Hamit Alemdar,nga DA- kryesues;
 - 1.2. Kelmend Maliqi,nga DA- anëtar,
 - 1.3. Gazmend Sejda,nga DA- anëtar.
2. Detyrat e Komisionit të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor, të bëjë vlerësimin e automjeteve të papërdorura që gjenden në hapësirat komunale dhe pas vlerësimit të gjendjes faktike, të caktojë çmimin fillestar të këtyre automjeteve.
3. Komisioni është organ i përkohshëm dhe mandati i tij përfundon me kryerjen e vlerësimit, siç përshkruhet në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Administratës, kryesuesi i Komisionit dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës;
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

